

VENDIM
Nr. 116, datë 6.3.2024

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SHITESË TË MARRËVESHJES SË GRANTIT DHE PROJEKTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË (MARRËSI) DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (FSHZH) (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT) DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR PROGRAMIN E RINDËRTIMIT TË NDËRTESAVE PUBLIKE (FAZA I), MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 1150, DATË 24.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes shtesë të marrëveshjes së grantit dhe projektit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (marrësi) dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit (FSHZH) (agjencia e zbatimit të projektit) dhe *KfW Frankfurt am Main (KfW)*, për programin e rindërtimit të ndërtesave publike (faza I), miratuar me vendimin nr. 1150, datë 24.12.2020, të Këshillit të Ministrave, me një grant në shumën 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) euro, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE SHITESË GRANTI

DATË 1.2.2024

NË LIDHJE ME MARRËVESHJEN E GRANTIT DHE PROJEKTIT, DATË 11 DHJETOR 2020 (“**MARRËVESHJA FILLESTARE E GRANTIT**”) NDËRMJET **KfW, FRANKFURT AM MAIN (“KfW”)** DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË (“**MARRËSI**”) DHE FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (ADF) (“**AGJENCIA ZBATUESE E PROJEKTIT**”)

PËR 3,500,000.00 EURO

**- PROGRAMI PËR RINDËRTIMIN E GODINAVE PUBLIKE (FAZA I) –
BMZ – NR. 2019 69 542**

Përmbajtja

Seksioni 1 – Termat

Seksioni 2 – Ndryshimet e marrëveshjes fillestare të Grantit

Seksioni 3 – Dispozitat shtesë

Seksioni 4 – Parashikimi i termave

Në lidhje me Marrëveshjen Fillestare të Grantit, Marrësi dhe KfW-ja lidhin marrëveshjen shtesë të mëposhtme të grantit (“Marrëveshja Shtesë e Grantit”).

Seksioni 1 – Termat

Në bazë të ndonjë dispozite të shprehur për të kundërtën në këtë Marrëveshje Shtesë të Grantit ose nëse konteksti nuk e parashikon ndryshe, termat e përcaktuar në Marrëveshjen Fillestare të Grantit do të kenë kuptim të njëjte edhe në këtë Marrëveshje Shtesë të Grantit.

Seksioni 2 – Ndryshimet e Marrëveshjes Fillestare të Grantit

2.1 Dispozitat e mëposhtme të Marrëveshjes fillestare të Grantit do të ndryshohen si më poshtë:

a) Fjalja e parë e nenit 1.1 do të fshihet dhe zëvendësohet si vijon:

“KfW-ja i jep Marrësit një shumë që nuk kalon totalin prej 14.500.000.00 eurosh (me fjalë: 14 milionë e pesëqind mijë euro) (“**Granti**).”

2.2 Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes fillestare të Grantit mbeten të pandryshuara.

Seksioni 3 – Dispozitat shtesë

Me përjashtim të nenit 9.5 të Marrëveshjes fillestare të Grantit, marrëdhëniet juridike të vendosura nga Marrëveshja fillestare e Grantit dhe kjo Marrëveshje Shtesë Granti ndërmjet KfW-së dhe Marrësit do të përfundojnë me realizimin e suksesshëm të Projektit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje Shtesë të Grantit.

Seksioni 4 – Përmbajtja e termave

Dispozitat e nenit 5 (Kostot dhe tarifat publike), neneve 6.1 dhe 6.2 (Deklaratat kontraktuale dhe kompetencat e përfaqësimit) dhe neneve 9.2, 9.3 dhe 9.4 (Dispozita të ndryshme) të Marrëveshjes fillestare të Grantit do të përfshihen në këtë Marrëveshje Shtesë Granti dhe do të jenë pjesë integrale e Marrëveshjes Shtesë të Grantit. Në rastet kur në klauzola referohet për “Marrëveshjen” ose “këtë Marrëveshje”, këto referenca janë për këtë Marrëveshje Shtesë Granti.

Hartuar në 3 dokumente origjinale në gjuhën angleze.

Frankfurt am Main, 1.2.2024

[Vendi dhe data]

KfW

Emri: Arne Goss

Titulli: Drejtor i Departamentit Infrastruktura Bashkiake
Evropa Juglindore dhe Turqia

Emri: Brit Horschke

Titulli: Drejtor i vendit KfW

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë

Emri:

Titulli: Zëvendësministër

Përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ami Kozeli

Fondi Shqiptar i Zhvillimit (ADF)

Dritan Agolli

Emri:

Titulli: Drejtor Ekzekutiv